



Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën

Parimi: Viktimat dhe të mbijetuarit/at e konfliktit të armatosur duhet të trajtohen me integritet dhe dinjitet

Studim i rastit



Parimet për ballafaqimin me të kaluarën

Parimet për ballafaqimin me të kaluarën është një iniciativë qytetare, e promovuar nga koalicioni jo formal i përbërë nga 5 organizata dhe një eksperte: Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë, Qendra Kosovare për Rehabilitimin të Mbijetuarve të Torturës, Integra, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, BIRN dhe Nora Ahmetaj. Grupi ka ndërmarrë një iniciativë të përbashkët për të hartuar dhe aprovuar një grup parimesh të cilat do të informojnë dhe udhëzojnë akterët politik dhe publik se si do të trajtojnë viktimat, të mbijetuarit/at, të kaluarën e dhimbshme dhe narrativat historike. Iniciativa ka për qëllim që të parandalojë diskursin dhe veprimet e dëmshme në lidhje me trashëgiminë e konfliktit dhe do të shërbejë si dokument referues, ku secili/a që shkel parimet e tij/saj duhet të mbahet moralisht përgjegjës. Andaj, qëllimi është që të aplikohen këto parime dhe të respektohen vlerat dhe ndjenjat që ato mishërojnë, në mënyrë që të sigurohet që viktimat dhe të mbijetuarit të mos dëmtohen dhe se veprimet që ndërliken me ballafaqimin e të kaluarës do të kontribuojnë në procesin e pajtimit¹. Tani kur parimet janë zhvilluar e janë organizuar, gjithashtu edhe janë të shpjeguara mirë, ka një rëndësi kruciale që të prezantohen tek një publik i gjerë dhe të promovohen në mënyrë korrekte. Ne besojmë se një nga mënyrat për të bërë njerëzit të kuptojnë për rëndësinë e parimeve është të tregohet për dëmet, pasojat dhe dhimbjen, të cilat mund të shkaktohen në situatat kur parimet janë të shkelura. Prandaj koalicioni do të publikojë disa analiza të cilat do të përpilohen nga ana e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) dhe ne do të përpiqemi që të sjellim shembuj konkret nga e kaluara ku parimet janë përdorur në mënyrë të duhur apo edhe janë keqpërdorur. Një nga këto parime është “Viktimat dhe të mbijetuarit/at e konfliktit të armatosur duhet të trajtohen me integritet dhe dinjitet”.

Viktimat dhe të mbijetuarit/at e konfliktit të armatosur duhet të trajtohen me integritet dhe dinjitet

Shoqëria duhet të pranojë vuajtjet e viktimave dhe t'i trajtojë me respekt dhe dinjitet. Stigma dhe paragjykimet e dëmshme duhet të kundërshtohen në të gjitha nivelet. Kjo është thelbësore për të mbështetur viktimat në riintegrimin e tyre në shoqëri. Shoqëria në Kosovë duhet t'i trajtojë në mënyrë të barabartë gratë, burrat dhe fëmijët që kanë vuajtur gjatë konfliktit. Përmes përfshirjes së tyre në shoqëri, përvojat e tyre njihen dhe respektohen.

Hyrje

Sipas Zyrës për Programe të Drejtësisë, në kuadër të Departamentit të Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara, thuhet se “baza e të drejtave të viktimave të krimit përfshin ndër tjerash të drejtën për tu trajtuar në mënyrë të barabartë, me dinjitet, ndjeshmëri dhe respekt²”.

Të drejtat e viktimave janë të mbrojtura edhe me legjislacionin tonë në fuqi, e gjithashtu të garantuara edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Këto të drejta bëjnë pjesë dhe garantohen në kuadër të të drejtave elementare të njeriut, si të drejta të pacenueshme, të cilat normalisht mbrohen dhe respektohen edhe gjatë procedurave të ndryshme penale.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës që paraqet aktin më të lartë juridik të vendit tonë, në kuadër të normimeve të saj, respektivisht në nenin 23 dhe 26 të saj, mbron dinjitetin dhe integritetin e njeriut. Sipas këtyre neneve thuhet se “dinjiteti i njeriut është i pancënueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut” dhe se “secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj³”.

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq në njërën nga publikimet e veta e ka theksuar nevojën që “shoqëria duhet

¹ Principi ALB (yih-ks.org)

² Office of Justice Programs, U.S. Department of Justice, <https://www.victimlaw.org/victimlaw/pages/victimsRight.jsp>

³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 23 dhe 26, Faqe 7, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>



t'ia mësojë gjeneratave të reja standardet minimale të sjelljes të cilat sigurohen që integriteti dhe dinjiteti i njerëzve respektohet si në kohë të paqes ashtu edhe të luftës⁴". Sipas një publikimi të Sbunker, thuhet se "Kur tregohen historitë e viktimave, viktimat bëhen diçka më shumë se një numër. Përmes përfshirjes së tyre në një kolektiv, përvojat e tyre jepen me vlerë dhe kuptim⁵".

Prandaj duke e parë rëndësinë që viktimat e luftës në Kosovë të trajtohen dinjitetshëm dhe që përvojat e tyre të përfshihen në mënyrë të barabartë në shoqëri, në vijim të kësaj analize do të shtjellojmë një rast në të cilin një e mbijetuar e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, e ka rrëfyer publikisht historinë e saj të dhunimit. Ky rast studimi paraqet një shembull të mirë të respektimit të parimit këtij parimi. E përpos që ajo ka marrë një hap kaq të rëndësishëm në jetën e saj, e njëjta ka avokuar edhe më tej që të njihen të gjitha përjetimet e viktimave të dhunës seksuale në Kosovë. Si rezultat, rrëfimi i saj ka hasur në pritshmëri jashtëzakonisht pozitive nga akterët shtetërorë e joshetërorë, por gjithashtu ajo është pritur me të njëjtën energji edhe nga qytetarët e Republikës së Kosovës, si dhe ka marrë përkrahje të madhe qytetare. Rrëfimi i saj është dëgjuar anë e kënd Kosovës, por edhe më gjërë.

Rasti i Vafije Krasniqit

Me rastin e shënimit të 19 vjetorit të Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) dhe në bashkëpunim me Radio Televizionin e Kosovës (RTK), Vafije Krasniqi, e mbijetuar e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, u intervistua dhe e shpali historinë e saj me të gjithë të pranishmit dhe shikuesit të cilët po e ndiqnin atë. Ajo publikisht tregoi historinë e dhunimit të saj, kur ishte vetëm 16 vjeçare⁶.

Një rrëfim të tillë, të cilin e kishte bërë Krasniqi kishte qenë rrëfimi i parë i hapur i njëjës prej viktimave të dhunës seksuale në Kosovë⁷. Dhe si i tillë, rrëfimi i saj kishte marrë shumë përkrahje, si dhe i ishte bërë rrugë për njohje të viktimave të tjera të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.

Në po të njëjtën ditë kur edhe e kishte treguar historinë e saj, përkrahja e parë i kishte ardhur nga ish presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga. Në një postim në profilin e saj në rrjetin social Facebook ajo kishte shkruar se Vafije Krasniqi "e theu heshtjen duke folur hapur për përvojën e saj të hidhur si pasojë e krimit që është kryer mbi të... Prandaj, shembulli i Vafijes është tregim i shpresës se, përkundër vështirësive, me përkushtim nga secili prej nesh, ne do ju sigurojmë të mbijetuarve se ata dhe ato nuk janë vetëm, dhe se ne do të jemi gjithmonë pranë tyre - sidomos në betejën e radhës, atë të qasjes në drejtësi⁸!".

Rrëfimi i Vafije Krasniqit kishte inkurajuar një numër të madh të viktimave që të aplikojnë për të marrë statusin e tyre si viktimat e dhunës seksuale në Kosovë. Një gjë të tillë e ka konfirmuar portali online Insajderi, ku thuhej se vetëm gjatë javës në të cilën ishte deklaruar Krasniqi, rreth 700 gra të dhunuara gjatë luftës janë verifikuar nga Komisioni Shtetëror për Verifikimin e Viktimave të Dhunës Seksuale⁹.

Duke i dhënë përkrahjen e duhur karshi përjetimeve të saj, është mundësuar që ajo të përfshihet në shoqëri si e barabartë me të gjithë qytetarët e tjerë, duke i njohur dhimbjet e saj, si dhe të shumë viktimave të tjera të cilat/cilët kanë ndarë eksperiencat e ngjashme sikurse të saj.

Vafije Krasniqi duke qenë viktimat e parë e cila publikisht e kishte rrëfyer historinë e saj, u përgëzua jashtëzakonisht shumë nga akterë të ndryshëm vendor, të cilët e nderuan për kurajon dhe guxim të cilin ajo tregoi duke shpalosur historinë e saj para të gjithëve. Në këtë mënyrë ajo u bë zë i shumë viktimave të heshtura të cilat/cilët ishin mbështjellur me petkun e stigmës. Ajo i frymëzoi të gjithë që të luftonin për të drejtat të cilat

⁴ International committee of the Red Cross, Protection of victims of armed conflict through respect of International Humanitarian Law, <https://www.icrc.org/en/doc/resources/documents/misc/57jpnz.htm>

⁵ Sbunker, Viktimologjia në drejtësinë tranzicionale, <https://sbunker.net/te/89998/viktimologjia-ne-drejtisine-tranzicionale/>

⁶ Online video, RTK, 16.10.2018, https://www.youtube.com/watch?v=0xalrKa_bNg

⁷ Telegrafi, 17.10.2018, <https://telegrafi.com/rrefimi-vafije-krasniqit-dy-dekada-pas-tmerrit-te-perjetuar-gjate-luftes-ne-kosove-video/>

⁸ Insajderi, 16.10.2018, <https://insajderi.org/postimi-prekes-i-jahjages-me-gruan-kosovare-viktme-e-dhunes-seksuale-gjate-luftes/>

⁹ Insajderi, 16.10.2018, <https://insajderi.org/kush-eshte-vafije-krasniqi-goodman-gruaja-e-dhunar-gjate-luftes-qe-do-rrefehet-sonte-publikisht-ne-rtk/>



i takonin ligjërisht dhe të kërkonin drejtësi për krimet e kryera ndaj tyre.

Për guximin e saj ajo mori dekorata të ndryshme nga institucionet më të larta shtetërore. Pas prononcimit të saj televiziv, ajo u dekorua me titullin “Qytetar i Merituar i Republikës së Kosovës”, nga presidenti i atëhershëm i Kosovës, Hashim Thaçi. Në fjalimin të cilin e kishte mbajtur ish presidenti, ai e kishte falenderuar për trimërinë e jashtëzakonshme të cilën e kishte treguar Vasfije Krasniqi. Ndër tjerash kishte thënë se këtë dekoratë ai e ndau “për veprimtarinë dhe kontributin e dhënë në mbrojtjen dhe promovimin e së vërtetës”.

Gjithashtu në po të njëjtën ditë ajo ishte takuar edhe me kryeministrin e atëhershëm të Kosovës, Ramush Haradinaj, i cili i kishte thënë se “duke u bërë shembull për shumë viktima të tjera, ju jeni zëri i së vërtetës që ka ndodhur mbi popullin tonë dhe në këtë mënyrë ju hapni rrugë për drejtësinë që ka munguar për dy dekada”. Pas këtij takimi Vasfije Krasniqi u deklarua se me përkrahjen të cilën ajo e ka marrë nga familja dhe nga rrethi i saj, ajo ka arritur që të vazhdojë jetën dhe në këtë mënyrë të bëhet zëri i shumë viktimave të tjera¹⁰.

Përpos të lartpërmendurave, Vasfije Krasniqi mori mirënjohje edhe nga ana e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). Këtë mirënjohje ajo e pranoi nga ish ministri i MKRS-së, Kujtim Gashi, “për kontributin e veçantë dhe të rrallë në sensibilizimin e opinionit vendor e ndërkombëtarë përmes artit për përjetimet dhe vuajtjet e mbi 20 mijë grave shqiptare gjatë luftës 1998-1999 në Kosovë¹¹”.

Një ditë pas deklarimit të saj publik, Vasfije Krasniqi ishte prituri nga ish kryetari i komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri. Ky i fundit i kishte ndarë titullin “Emblema e Vushtrrisë”, për shkak të “guximit të jashtëzakonshëm, për thyerjen e stigmës...¹²”

Në nder të kësaj kategorie të viktimave, simboli i pavarësisë së Kosovës “NEWBORN”, në 12 vjetorin e shpalljes së pavarësisë, i ishte kushtuar “të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës, me qëllim të rritjes së vetëdijes së popullatës për gjendjen e të mbijetuarve, por veçanërisht luftimin e stigmës dhe mobilizimin për më shumë mbështetje për të mbijetuarit”. Sipas drejtoreshës së QKRMT, Feride Rushiti, secila nga shkronjat e “NEWBORN” janë të ndërthurura me rrëfimet e viktimave të dhunës seksuale kudo në botë¹³.

Rrëfimi i Vasfije Krasniqit jo vetëm që ishte dëgjuar në Kosovë, por edhe në Kongresin Amerikan e atë Italian.

Më 30 prill 2019 në Komitetin për Punë të Jashtme në New York, ishte mbajtur një seancë dëgjimore, në të cilën Vasfije Krasniqi dha dëshminë e saj të dhunimit gjatë luftës në Kosovë¹⁴. Kjo bëri që të gjithë të pranishmit të bashkëndjenin me të.

Më 26 qershor 2019 historia e Vasfije Krasniqit u dëgjua edhe nga përfaqësuesit e Senatit dhe Kongresit të Italisë, ku ajo dëshmoi në lidhje me dhunimet të cilat kanë ndodhur në luftën e fundit në Kosovë¹⁵.

Në këtë mënyrë ajo historinë e saj e përdori si mjet për të njohur të gjitha viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, si dhe përvojat e tyre të njihen e respektohen.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021, Vasfije Krasniqi kishte kandiduar për t’u zgjedhur si deputete, duke thënë se “do të kandidoj për një ulëse në Kuvendin e Republikës së Kosovës në mënyrë që edhe më aktivisht t’i përfaqësoj të mbijetuarat/it e dhunës seksuale nga lufta e fundit në Kosovë¹⁶”. E si rezultat, ajo u zgjodh në mesin e 10 deputeteve më të votuara të Kosovës¹⁷.

¹⁰ Albinfo.ch, 18.10.2018, <https://www.albinfo.ch/presidenti-i-iejep-medaljen-vasfije-krasniqi-goodman/>

¹¹ Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministri Gashi ndau mirënjohje për Vasfije Krasniqi Goodman, <https://www.mkrs-ks.org/?page=1,6,2136#.Yh9txorMKUk>

¹² Kallxo.com, 19.10.2018, <https://kallxo.com/shkurt/vasfije-krasniqi-goodman-dekorohet-me-titullin-emblema-e-vushtrrise/>

¹³ RTK Live, 17.02.2020, <https://www.rtklive.com/sg/news-single.php?ID=412388>

¹⁴ Kosovo’s wartime victims: the quest for justice, hearing before the committee on foreign affairs house of representatives, Page 5, <https://docs.house.gov/meetings/FA/FA00/20190430/109398/HHRG-116-FA00-Transcript-20190430.pdf>

¹⁵ Koha.mk, 25.06.2019, <https://www.koha.mk/vasfije-krasniqi-goodman-neser-deshmon-para-senatit-dhe-kongresit-italian/>

¹⁶ RTK Live, 18.01.2021, <https://www.rtklive.com/sg/news-single.php?ID=493476>

¹⁷ Telegrafi.com, 04.03.2021, <https://telegrafi.com/10-femrat-te-votuara-ne-kosove/>



Rrëfimi dhe guximi të cilën e kishte treguar Vassije Krasniqi, kishte bërë që ajo të njihet dhe të vlerësohet nga të gjithë qytetarët e Kosovës dhe në mënyrë indirekte të i ndihmonte edhe të gjithë viktimat e tjera të kësaj kategorie, që të njihen dhe respektohen nga të gjithë.

Siç është shpjeguar më lartë, analiza paraqet një rast pozitiv, që duhet inkurajuar dhe përshëndetur, por jo të gjitha viktimat e luftës në Kosovë janë trajtuar në këtë mënyrë. Rasti i Vassije Krasniqit duhet të merret si model se si duhet të përkrahen dhe trajtohen viktimat e luftës në Kosovë.

Rekomandime

Në rend të parë rekomandojmë që “Parimet për Ballafaqimin me të Kaluarën¹⁸”, të respektohen dhe adaptohen nga të gjithë akterët politik dhe publik, e të cilët merren me trajtimin e së kaluarës.

Të gjithë akterët publik dhe politik, por edhe qytetarët e Republikës së Kosovës duhet të pranojnë dhe të trajtojnë në mënyrë të dinjitetshme të gjitha viktimat e luftës në Kosovës, e specifikisht viktimat e dhunës seksuale.

Ky projekt implementohet me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane në Kosovë dhe Ambasadës Britanike në Prishtinë përmes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, dhe përmbajtja e përfshirë në këtë analizë nuk pasqyron pikëpamjet e tyre.

¹⁸ [Principi ALB \(yihr-ks.org\)](http://PrincipiALB(yihr-ks.org))

 @dwpkosovo

 @dwpkosovo

 @dwpkosovo

 dwpkosovo